



stiftung  
naturschutz  
berlin

# play station unplugged



HAPËSIRAT E PËRVOJËS NË NATYRË PËR  
FËMIJËT NË BERLIN



## Përmbajtja

- 3 Editorial
- 4 Pse kemi nevojë për hapësira të përvojës me natyrën  
në qytetet e mëdha
- 6 Parakushtet dhe parimet
- 8 Shembulli i parë në Berlin
- 9 Më shumë hapësirë përvojë me natyrën për Berlinin
- 11 Informacione dhe lidhje të mëtejshme





**Kacavarje në pemë,** të luash me baltë, ndërtim digash, të kapësh bretkosat, të vesh brumbujt të vrapojnë në garë - kjo listë zgjon kujtime tek ju? Urime! Atëherë ju i përkisni numrit gjithnjë e më të vogël të njerëzve që patën fatin të provojnë natyrën në fëmijërinë e tyre, të cilët kishin mundësi ta eksplorojnë dhe ta kuptojnë në mënyrën e tyre. Përvoja të tilla qëndrojnë me ne për një jetë, na formojnë në dhe marrëdhënien tonë me natyrën. Kjo njohje bën, që diçka të rritet tek ne - një ndjenjë e lidhjes, familjaritetit dhe sigurisë. Ajo na nxit të jemi të vetëdijshëm, për të mbrojtur natyrën dhe mjedisin. Në botën e sotme, sidomos në qytetet e mëdha, ka vetëm pak vende ku fëmijët mund të zbulojnë natyrën lirshëm, pa ndalime, udhëzime dhe mbikëqyrje të vazhdueshme.

Për të luftuar këtë gjendje jo të mirë, u zhvillua në vitet 1990 koncepti i «hapësirave natyrore» (NERäume). Ideja e hapësirave të përvojës me natyrën ofron një mundësi të madhe për të kombinuar më shumë cilësi në jetën e fëmijëve dhe ruajtjes së natyrës së qytetit. Projekti i ri i testimit dhe zhvillimit «Hapësirat e përvojës së natyrës në qytetet e mëdha duke përdorur shembullin e Berlinit», që u krijua nga Shoqata Naturschutz Berlin, tani do të merret me krijimin sistematik, monitorimin dhe vlerësimin e hapësirave të përvojës në natyrë në një kontekst metropolitan.





## Pse kemi nevojë për hapësira të përjetimit të natyrës në qytetet e mëdha



### Përjetimi i natyrës është elementar

Dallimi kryesor midis fëmijërisë 50 vjet më parë dhe sot. Është, se sot ka më pak hapësirë të lirë disponueshme për fëmijët e qyteteve dhe se ata janë të «mbrojtur» gjatë gjithë kohës. Aktivitetet e tyre të lojës kanë lëvizur në mënyrë të pashmangshme nga jashtë në brendësi. Jeta e përditshme e fëmijëve në përgjithësi është e organizuar gjatë gjithë ditës dhe hapësira e veprimit të tyre është bërë shumë më e vogël. Deficite alarmuese zhvillimore në fushën fizike, mungesa e përqendrimit, mbipesha me problemet shëndetësore, që rrjedhin prej saj që rezultojnë, sjellja sociale e dobët dhe mungesa e ndërgjegjësimit mjedisor janë disa ndër pasojat. Lista mund të vazhdojë.

Disa studime shumëvjeçare kanë treguar, se sa e rëndësishme është që të luash lirshëm në natyrë. Kjo ndihmon në kontrollin e trupit, kreativitetin, njohjen e natyrshme të rrezikut dhe forcon aftësitë sociale. Prandaj ne duhet të krijojmë hapësira ku kjo gjë të bëhet përsëri e mundur.





## Sukseset e para

Në kuadër të projekteve të ndryshme kërkimore, është konstatuar se përvojat e vetjake në ambiente të jashtme janë të domosdoshme për zhvillimin e fëmijës. Kjo bëri që të zhvillohej koncepti i «hapësirave të përvojës me natyrën». Duke u bazuar në idenë se fëmijët në natyrë ose në zonat e orientuara nga natyra pa lodra ose infrastruktura të tjera lojërash, si dhe kryesisht pa mbikëqyrje dhe kujdestari përmes lojës së lirë mund të bëjnë përvojat e tyre.

Në vërtetimin e zonave të përvojës së natyrës në krahasim me terrenet e lojërave konvencionale është vënë ndër të tjera re, se:

### Fëmijët në zonat e përvojës së natyrës

- luajnë shumë më shpesh me fëmijët e tjerë sesa fëmijët që luajnë nëpër kënde lojërash,
- luajnë shumë më shpesh lojëra komplekse ose madje lojëra shumë më komplekse se sa fëmijët e tjerë nëpër kënde lojërash,
- qëndrojnë „më gjatë duke u marrë me diçka“ dhe nuk hutohen,
- janë përgjithësisht më të interesuar në mjedisin e tyre dhe kanë njohuri dhe bazë për kafshët dhe bimët,
- krijojnë gjëra vetë dhe e krijojnë vetë ambientin e tyre përreth,
- mund të tregojnë në mënyrë të detajuar, entuziaste dhe komplekse për aktivitetet e tyre.

Ky koncept është pëlqyer gjithashtu nga prindërit, siç kanë treguar sondazhet dhe diskutimet. Shumica e prindërve ishin në dijeni të efekteve pozitive të terreneve natyrore në zhvillimin fizik dhe psikologjik të fëmijëve të tyre. Pranimi është përkatësisht i lartë.

Si rrjedhojë e përvojave pozitive, koncepti i hapësirës të përvojës me natyrën tani po përfshihet në nivele të ndryshme të legjislacionit, planifikimit mjedisor dhe urbanistik si dhe në angazhime të tjera të misionit p.sh. gjithashtu në Aktin e ndryshuar Federal të Mbrojtjes të Natyrës 2010, në të cilin ruajtja dhe krijimi i habitateve natyrore përmendet si qëllimi i ruajtjes së natyrës dhe ruajtjes së peizazhit (§1, paragrafi 6 BNatSchG). Deri më tani, hapësirat e përjetimit të natyrës janë përfshirë në tre ligje mbrojtëse të lendeve (Rheinland-Pfalz, Berlin dhe Nord Rhein-Westfalen).

## Parakushtet dhe parime

Si rrjedhojë e zhvillimit urban në dekadat e fundit, hapësirat e përshtatshme të hapura janë zhvendosur gjithnjë e më shumë në favor të rritjes urbane. Rëndësia tyre për një qytet miqësor për fëmijët u njoh shumë më vonë. Tani është e rëndësishme për të siguruar potencialin hapësinor të mbetur. Zonat e përshtatshme duhet të jenë sa më të mëdha që të jetë e mundur, zona të lira që janë të integruara në zonat e banimit, të tilla si sipërfaqet gjysmë natyrore të gjelbëruara, toka djerrë dhe pyje ose zona pyjore.

Projekti i përshkruar më poshtë synon të kontribuojë në këtë drejtim.

Sipërfaqet e përshtatshme afër natyrës për fëmijët duhet që

- të jenë të përshtatshme për lojën e përditshme
- të jenë të krijueshme nga fëmijët që të kenë mundësinë të provojnë krijimtarinë e tyre për ta bërë kështu rezultatin e krijimtarisë së vet të dukshëm,
- të ofrojnë hapësira qetësie,
- të jenë të krijuara në mënyrë të larmishme dhe atraktive.





Kur kjo nuk është e mundur, mund të ndihmohet përmes vetkrijimit. Të përshtatshme janë mbjelljet me bimë, krijimi i kodrave dhe luginave ose sipërfaqeve ujore. Edhe terreni i hapur ofron kushte të mira për lojë kreative.

Planifikimi dhe krijimi i këtyre sipërfaqeve duhet bërë në bashkëpunim me fëmijët.

Ndërhyrjet e mirëmbajtjes duhet të bëhen vetëm që të mbahen të hapura zonat e përdorura duke u konsultuar me frekuentuesit. Sipërfaqet e tjera të zonës duhet të lihen që të zhvillohen natyrshëm dhe pa ndërhyrje.

Hapësirat për përvojën me natyrën janë kryesisht për fëmijët të moshës 3-12 vjeç, por edhe adoleshentët dhe

të rriturit nuk duhen përjashtuar. Me përjashtim të aktivitete të lojës me qëllimin për t'u njohur dhe për zvogëlimin e frikës kundrejt «natyrës së egër» duhet që mundësisht të mos bëhet asnjë kujdestari pedagogjike. Është e rëndësishme që fëmijët të jenë këtu me njëri-tjetrin dhe të bëjnë përvojat e tyre personale dhe unike. Kujdesi dhe kontrolli i sipërfaqes për të arsye të sigurisë në terrenin për lojë, duhet të garantohet po ashtu si edhe në këndet e lojërave.





## Shembulli i parë në Berlin

Hapësira e parë e përvojës në natyrë në Berlin u hap në qershor 2009 në parkun e Gleisdreieck. Ajo u frymëzua nga qytetarët sipas ideve të fëmijëve në kontekstin e ditëve të aksioneve të planifikuara dhe të zbatuara nga kompania Grün Berlin GmbH si një projekt pilot në një hekurudhë djerrë. Në planifikimin dhe zbatimin nga ARGE Hapësirat e përvojës me natyrën Berlin, ku u përfshinë edhe shumë fëmijë nga kopshtet e afërta të kujdesit të fëmijëve, të cilët kontribuan me fantazi në këtë proces. Hapësira e përvojës së natyrës është e mbikëqyrur shoqata Verein südost Europa Kultur e. V.

Sipërfaqja prej 3.500 m<sup>2</sup> ofron të gjitha llojet e stimuljeve. Disa kodra u ngritën dhe u krijuan hendeqe, të cilët mund të mbushen me ujë. Së bashku me fëmijët u mbollën pemë frutore dhe shkurre e manaferrash si edhe u vendosën disa shkëmbinj e gurë. Materiale natyrore, të tilla si degë dhe shkopinj për krijime kreative janë gjithashtu pjesë e pajisjeve. Vlerësimet fillestare tregojnë se kjo hapësirë natyrore e përvojës është mirëpritur, veçanërisht nga fëmijët e shkollav.








## Më shumë hapësirë për përvojën në natyrë për Berlinin - një projekt i Fondacionit Naturschutz Berlin

Tek shoqata Naturschutz Berlin në vitet 2011/2012 u krye një verifikim paraprak për testimin dhe zhvillimin e projekteve të sponsorizuar nga fondet federale për "Hapësirat e përvojës në natyrë në qytetet e mëdha sipas shembullit të Berlinit" (raporti i projektit: [www.bfn.de/fileadmin/MDB/documents/service/script\\_345.pdf](http://www.bfn.de/fileadmin/MDB/documents/service/script_345.pdf)). Kjo fazë e parë e projektit shërbeu për të sqaruarkërkësat themelore dhe përzgjedhjen e zonave pilot të përshtatshme.

Në mes të gushtit të vitit 2015 filloi faza e dytë e projektit kryesor. Rrethet Marzahn-Hellersdorf, Pankow dhe Spandau u krijuan tre zona të përvojës në natyrë që shërbenin si një shtojcë ose kualifikim i zonave të lira publike ekzistuese, të cilat tani janë në fazë testi. Këtu duhet të merren parasysh aspektet sociale, shëndetësore, arsimore, ekologjike dhe ekonomike. Projektet ka një afat prej tre vjetësh dhe do të mbështetet shkencërisht nga Universiteti për Zhvillim të Qëndrueshëm në Eberswalde. Rezultatet e përfituara duhet të dokumentohen në fund të projektit, që të bëhen një udhëzues për qytete dhe aktorë të tjerë.





## Hapësirat e reja të përvojës në natyrë

Për realizimin u zgjodhën tre zona në Kienberg në Marzahn, në Spieroweg në Spandau dhe pranë Moorlinse Buch në Pankow. Në të tre rastet, jetojnë në këto rrethina shumë fëmijë, të cilët mund të përfitojnë nga gama e re e lojërave dhe përvojave. Të gjitha zonat janë afër apartamenteve të mëdha të banimit dhe janë pjesë e programit të financimit për zhvillimin e integruar urban “Zukunftsinitiative Stadtteil II”, i cili synon të zvogëlojë kushtet e pabarabarta të jetesës në brendësi të qytetit dhe aktivizimin e potencialit lokal.

**Natyra e egër në Spieroweg** është një sipërfaqe e djerrë e ndërthurur larmishmërisht me karakter xhungle. Pemë të ndryshme frutash dhe arra, shkurre me strukturë të dendur dhe dhe rrugicat që përshkojnë bimësinë e larte ftojnë për të ngrënë, për tu fshehur dhe për të eksploruar. NER Spieroweg u hap zyrtarisht në 2016 dhe që atëherë dhe i shërben publikut për zbavitje dhe çlodhje në kohën e lirë. **Robert Welzel, Staakkato Kinder und Jugend e.V. jep informacione rreth hapësirës së përvojës në natyrë dhe koordinon grupet e fëmijëve në vend (Regjistrimet në grup): 0151 15 35 38 92.**

Ndryshimi midis zonave me drurë të rinj dhe të vjetër me dritë-hije karakterizojnë **Imazhin i natyrës së egër në Moorwiese**. Së bashku me peizazhin e hapur në kufi dhe këndin të lojërave aventurë, kjo hapësirë për përvojën në natyrë ka një tërheqje të veçantë për fëmijët. Kjo hapësirë për përvojën në natyrë u hap në shtator 2016. **Personat e kontaktit lokal janë Martyn Sorge dhe Julia Obert, Spielkultur Berlin Book e.V., i cili ju informon për aktivitetet dhe mundësitë në NER: 0157 85 33 88 86, Regjistrimi i grupit bëhet gjithashtu nëpërmjet NER@spielkulturBuch.de**

**Natyra e egër në Kienberg** është pothuajse e plotë me pyje. Struktura e pyjeve dhe pjerrësisë e terrenit lejon lojërat dhe eksplorimin në mënyrë “të pa vëzhguar”. Kjo hapësirë për përvojën në natyrë është pjesë e ekspozitës ndërkombëtare të kopshtarisë Berlin 2017 e cila zhvillohet në nga 13 prilli deri më 15 tetor 2017. në Berlin-Marzahn. Gjatë ekspozitës mund të bëhen aktiviteti nga kopshtet dhe grupet e shkollave fillore brenda kuadrit të klasës IGA rreth temës “zbulimi i natyrës nëpërmjet lojës” **Eike Friederici, INU gGmbH, kujdeset për këtë hapësirë të përvojë në natyrë dhe është personi i kontaktit pas ekspozitës. Personi kontaktues dirket në vend: 0152 26 13 97 69, ner@inuberlin.de.**

| Sipërfaqja pilot                         | NER Moorwiese                             | NER Kienberg                                                 | NER Spieroweg                                          |
|------------------------------------------|-------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|
| Ku?                                      | Wiltbergstr. 29a<br>13125 Berlin-Buch     | Kienberg<br>12685 Berlin-Marzahn                             | Cosmarweg/Ecke Spieroweg<br>13591 Berlin-Staaken       |
| Pronari i sipërfaqes/<br>-Administratori | Bezirk Pankow                             | Grün Berlin GmbH                                             | Bezirk Spandau                                         |
| Institucioni i kujdesjes                 | Spielkultur<br>Berlin-Buch e.V.           | INU gGmbH                                                    | Staakkato Kinder und<br>Jugend e.V.                    |
| Zyra planit                              | Susanne Pretsch<br>Landschaftsarchitektin | Beissert & Hengge<br>Garten- und Landschafts-<br>architekten | Sabine & Michael Kinder<br>Planungsbüro Naturspielraum |



# Impressum

## deklarata e autorësisë / pronësisë

Hapësirat e përvojës me natyrën për fëmijët e Berlinit

Projekti financohet nga Agjencia Federale për Ruajtjen e Natyrës e Ministrisë Federale për Mjedisin, Ruajtjen e Natyrës, Ndërtimin dhe Sigurisë Bërthamore, si dhe përmes qarkut Pankow. Departamenti i Senatit për Mjedisin, Transportin dhe Mbrojtjen e Klimës Berlin mbështet nga Komisioneri i Shtetit për Ruajtjen e Natyrës dhe peisazhit që Berlin.

## Botuesi i Broshurës:

Shoqata mbrojtja e natyrës Berlin

Kryesia: Annette Nawrath (Krye.),  
Reinhard Schubert (Stellv. Vors.), Dr. Sylvia Ortmann  
Drejtori menaxhues: Holger Wonneberg  
Potsdamer Str. 68  
10785 Berlin  
Tel.: (030) 26 39 40  
Fax: (030) 261 52 77  
E-Mail: mail@stiftung-naturschutz.de  
Internet: www.stiftung-naturschutz.de

## Hartuesi:

Irma Stopka, Drejtuese e Projektit „Ambienti i përvojës me natyrën në zonat urbane si psh. në Berlin”

## Përpunimi i redaktimit:

Heidrun Grüttner

## Dizenjimi grafik:

Camilla Hoffmann

## Fotografite:

Camilla Hoffmann  
Lichtschwärmer: Fotos Seite 8  
(Hapësira e përvojës me natyrën në Gleisdreieck)

Gusht 2017  
e shtypur me letër 100% të riciklueshme me Umweltengel



## Lidhje të mëtejshme

### Hapësira të përvojës me natyrën:

Grupi punës së urbanistikës Naturerfahrungsräume:

» [www.naturerfahrungsraum.de/](http://www.naturerfahrungsraum.de/)

Hapësira të përvojës me natyrën në qytetet e mëdha  
Raport përmbyllës i vërtetimit nga E+E-Vorhaben

» [www.bfn.de/fileadmin/MDB/documents/service/skript\\_345.pdf](http://www.bfn.de/fileadmin/MDB/documents/service/skript_345.pdf)

### Broshura të përjetojmë natyrën dhe ujin

» [www.wasser.rlp.de/servlet/is/7842/Blaue\\_Broschuere.pdf?command=downloadContent&filename=Blaue\\_Broschuere.pdf](http://www.wasser.rlp.de/servlet/is/7842/Blaue_Broschuere.pdf?command=downloadContent&filename=Blaue_Broschuere.pdf)  
„Fëmijët dhe natyra në qytet”, BfN-Skript 230

» [www.bfn.de/fileadmin/MDB/documents/service/skript230.pdf](http://www.bfn.de/fileadmin/MDB/documents/service/skript230.pdf)

### Fëmija natyra dhe shëndeti:

Guxim për natyrën – Fëmijët kanë nevojë për më tepër natyrë

» [www.wildnisschule-waldkauz.de/Artikel/Natur%20und%20Kinder.pdf](http://www.wildnisschule-waldkauz.de/Artikel/Natur%20und%20Kinder.pdf)

Fëmijët jashtë në natyrë

» [www.geo.de/GEO/natur/oekologie/kinder-raus-in-die-natur-64781.html?p=1](http://www.geo.de/GEO/natur/oekologie/kinder-raus-in-die-natur-64781.html?p=1)

Si ndikon natyra dhe terreni në shëndetin, mirëqenien dhe kualitetin e jetës?

» [www.bfn.de/fileadmin/MDB/documents/ina/Leksione/2011/2011-Naturbewusstsein-Gebhard.pdf](http://www.bfn.de/fileadmin/MDB/documents/ina/Leksione/2011/2011-Naturbewusstsein-Gebhard.pdf)

### Largimi i fëmijëve prej natyrës:

Rëndësia e përjetimit të natyrës për fëmijët:

» [www.kindergartenpaedagogik.de/1740.html](http://www.kindergartenpaedagogik.de/1740.html)

### Titulli E+E-Vorhaben:

» [www.bfn.de/0202\\_eue.html](http://www.bfn.de/0202_eue.html)

